

Në bazë të nenit 94, paragrafit 1, pikës 39 dhe pikës 40 dhe nenit 107, të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 82/2018), nenit 27, paragrafit 1, pikës 6, nenit 31, paragrafit 1, pikës 21, nenit 47 dhe nenit 119, të Statutit të Universitetit të Evropës Juglindore, Bordi i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 9.09.2019, e miratoi këtë:

RREGULLORE PËR PRANIMIN E DENONCIMEVE PËR KORRUPSION

I. Objekti i rregullimit

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra dhe procedura për pranimin e denoncimeve për korrupsion.

Neni 2

- (1) Me qëllim të parandalimit dhe mbrojtjes efikase nga korrupsioni, nga radha e profesorëve ordinarë, sipas një procedure të caktuar zgjidhet personi i autorizuar për pranimin e denoncimeve për korrupsion.
- (2) Personi i autorizuar për pranimin e denoncimeve për korrupsion zgjidhet nga Senati i Universitetit për periudhë prej 3 vitesh, me të drejtë edhe për një zgjedhje.

II. Përkufizimi i korrupsionit

Neni 3

- (1) Korrupsioni nënkupton keqpërdorimin e funksionit, autorizimit publik, detyrës apo pozitës zyrtare për realizim të dobisë, drejtpërdrejt ose nëpërmjet ndërmjetësuesit, për vete ose për një person tjetër.
- (2) Korrupsioni përfshin nocionet e:
 - korrupsionit pasiv – veprim i qëllimshëm i personit zyrtar, i cili drejtpërdrejt ose tërthorazi, kërkon ose pranon dobi në cilëndo formë, për vete ose për person të tretë, ose pranon premtim për dobi të këtyllë, me qëllim të veprjës apo të përmbahet nga veprimi, në pajtim me obligimet e tij, ose t'i ushtrojë kompetencat e tij në kundërshtim me obligimet zyrtare, dhe
 - korrupsionit aktiv - veprim i qëllimshëm i cilitdo person, i cili drejtpërdrejt ose nëpërmjet ndërmjetësuesit, premtim ose jep dobi në çfarëdo forme për person zyrtar, për vete, ose për një person të tretë, me qëllim të veprjës, ose të përmbahet prej veprimit në pajtim me obligimet e tij e në kundërshtim me obligimet zyrtare.

III. Denoncuesi

Neni 4

Denoncues mund të jetë:

- personi, i cili ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të caktuar, ose të pacaktuar në Universitet;
- kandidati për punësim në Universitet
- kandidati për praktikant në Universitet;
- personi, i cili është, ose ka qenë praktikant në Universitet;
- personi, i cili në çfarëdo baze është, ose ka qenë i angazhuar për realizimin e punës në Universitet;
- personi, i cili në çfarëdo baze është, ose ka qenë në marrëdhënie afariste, ose marrëdhënie tjetër bashkëpunimi me Universitetin;
- studentët që i shfrytëzojnë ose i kanë shfrytëzuar shërbimet e Universitetit;

Neni 5

(1) Denoncimi i korrupsionit kryhet me gojë, në procesverbal ose në formë të shkruar.

(2) Personi i autorizuar për pranimin e denoncimit të korrupsionit është i obliguar:

- të veprojë sipas denoncimit të paraqitur, në pajtim me procedurat e përcaktuara;
- t'i mbrojtë të dhënat personale të denoncuesit, respektivisht të dhënat që mund ta zbulojnë identitetin e denoncuesit, i cili kërkon të jetë anonim, ose denoncon në mënyrë konfidenciale, në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale;
- ta informojë denoncuesin, i cili është i njohur për masat e marra në lidhje me denoncimin pa prolongim, kurse më së voni në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimin të kallëzimit;
- të paktën dy herë në vit të paraqesë raport mbi punën e tij para Senatit të Universitetit.

Neni 6

Universiteti obligohet që personit të autorizuar për pranimin e denoncimeve për korrupsion, përveç që duhet t'i sigurojë pavarësi dhe të mos e pengojë në ushtrimin e autorizimeve të tij, duhet po ashtu:

- t'i sigurojë hapësira të posaçme për punë dhe pranim të palëve;
- kompjuter të veçantë me fjalëkalim të veçantë, të njohur vetëm për personin e autorizuar.

IV. Dispozitat përfundimtare

Neni 7

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 01.10.2019.